

SHOQËRIA “BOTIMET ENCIKLOPEDIKE” SH.A.  
ADRESA: RR. “MUHAMET GJOLLESHA”, TIRANË  
NUIS J61807025P

VENDIM  
I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME  
TË SHOQËRISË “BOTIMET ENCIKLOPEDIKE” SH.A.

Sot, më datë 30 gusht 2022, në orën 10:00 në Tiranë, Shqipëri, pranë selisë së Shoqërisë “BOTIMET ENCIKLOPEDIKE” SH.A., në adresën: “Muhamet Gjollësja”, Tiranë (këtej e tutje “Shoqëria”), u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

Janë të pranishëm

- Znj. Greta Domi**, e dtl. 18.05.1984, lindur në Elbasan dhe banuese në Tiranë, e identifikuar me kartë identiteti me nr. personal I45518082P, përfaqësuese ligjore në votim në cilësinë e zotërueses aktive të aksioneve të:  
**Znj. Ajola Arben Xoxa**, dtl. 16/07/1983, lindur dhe banuese në Tiranë, identifikuar me kartë identiteti me nr. personal I35716050T, që zotëron që zotëron 2410 aksione të Shoqërisë, apo 19,803 % të kapitalit aksionar.
- Znj. Valbona Xhemil Xoxa**, dtl. 09/10/1958, lindur dhe banuese në Tiranë, identifikuar me kartë identiteti me nr. personal F86008097P, që zotëron 8484 aksione të Shoqërisë, apo 69,712 % të kapitalit aksionar, dhe që vepron në cilësinë e Kryetares së Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

E pranishme është edhe **Znj. Xhoi Skënderasi**, e dtl. 08.09.1992, lindur dhe banuese në Tiranë, identifikuar me letërnjoftim me nr. personal J25908048T që caktohet për të vepruar në cilësinë e Sekretarit të Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

Kryetarja e Asamblesë, Znj. V. Xoxa, deklaroi se mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme është thirrur dhe mbledhur rregullisht, konform ligjit dhe Statutit të Shoqërisë, pa patur ndonjë kundërshtim nga secili prej aksionerëve në lidhje me këtë, për të diskutuar e vendosur mbi Rendin e Ditës së mëposhtëm.

Rendi i Ditës

1. Propozimi dhe miratimi i ndarjes së njëjës prej njëjësive të Shoqërisë;
2. Miratimi i kontratave të shitjes së pjesëshme të aseteve të Shoqërisë;
3. Të ndryshme.

Pasi konstaton praninë e të gjithë aksionerëve të sipërpërmendur,

### Deklaron

mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë si të mbledhur rregullisht dhe të aftë për të diskutuar e vendosur në mënyrë të vlefshme mbi Rendin e Ditës.

## **I. PROPOZIMI DHE MIRATIMI I NDARJES SË NJËRËS PREJ NJËSIVE TË SHOQËRISË**

Kryetarja e mbledhjes merr fjalën dhe sqaron se Shoqëria disponon disa prona të paluajtshme, të regjistruara në ZK.8210 Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Veri me adresë Rruga Muhamet Gjollesha.

Kryetarja me qëllim përdorimin me efikasitet të njërës prej njësive propozon ndarjen e saj në dy njësi të veçanta (jo të barabarta), të pasurisë me të dhënat si vijon:

- Prona me Nr. Pasurie 5/139-N9 e llojit Njësi, e ndodhur në ZK. 8210, Vol. 9, Faqe.81, me adresë Bashkia Tiranë, Rruga “Muhamet Gjollesha”, me sipërfaqe totale 400.5 m<sup>2</sup> (katërqind pikë pesë) e regjistruar rregullisht në regjistrat e pasurive të paluajtshme pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Veri, vërtetuar nga Certifikata për Vërtetim Pronësie e datës 25.01.2019 me numër serial 1783864.

## **II. MIRATIMI I KONTRATAVE TË SHITJES SË PJESSHME TË ASETETEVE TË SHOQËRISË**

Kryetarja e mbledhjes sqaron se në lidhje me miratimin e kontratave të shitjes së pjeshme të aseteve të Shoqërisë, Shoqëria ka marrë një ofertë shumë të favorshme për shitjen e disa prej tyre. Në vijim Kryetarja i paraqet Asamblesë ofertën në lidhje me tjetërsimin e aseteve me të dhënat si vijon:

- Prona me Nr. Pasurie 5/139-N9, lloji Njësi, e ndodhur në ZK. 8210, Vol. 9, Faqe.81, me adresë Bashkia Tiranë, Rruga “Muhamet Gjollesha”, me sipërfaqe totale 400.50 m<sup>2</sup> (katërqind pikë pesë) e regjistruar rregullisht në regjistrat e pasurive të paluajtshme pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Veri, vërtetuar nga Certifikata për Vërtetim Pronësie e datës 25.01.2019 me numër serial 1783864;
- Prona me Nr. Pasurie 5/156+1-N11, lloji Njësi, e ndodhur në ZK. 8210, Vol. 10, Faqe 67, me adresë Bashkia Tiranë, Rruga “Muhamet Gjollesha”, me sipërfaqe totale 48 m<sup>2</sup> (dyzet e tetë) e regjistruar rregullisht në regjistrat e pasurive të paluajtshme pranë Agjencisë

Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Veri, vërtetuar nga Certifikata për Vërtetim Pronësie e datës 17.05.2016 me numër serial 1410755;

- Prona me Nr. Pasurie 5/360, lloji Truall, e ndodhur në ZK. 8210, Vol. 33, Faqe.213, me adresë Bashkia Tiranë, Rruga “Muhamet Gjollësia”, me sipërfaqe totale 415.88 m<sup>2</sup> (katërqind e pesëmbëdhjetë pikë tetëdhjetë e tetë) e regjistruar rregullisht në regjistrat e pasurive të paluajtshme pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Veri, vërtetuar nga Certifikata për Vërtetim Pronësie e datës 28.01.2016 me numër serial 1279715.

Në lidhje me Rendin e Ditës, Kryetarja i hedh në diskutim dhe në vijim të deklarimeve të sipërlistuara, pas një diskutimi të gjatë dhe gjithëpërfshirës, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë, unanimitisht:

#### VENDOS

1. Miratimin e ndarjes së njësisë së sipërcituar në dy njësi të veçanta.
2. Miratimin në parim të shitjes së aseteve të sipërpërmendura dhe miratimin e kontratave të shitjes së tyre.
3. Autorizimin e Administratores së Shoqërisë, dhe në mungesë të saj çdo person tjetër të autorizuar prej saj, për kryerjen dhe ndjekjen e të gjitha procedurave ligjore të kërkuara nga legjislacioni shqiptar për reflektimin e ndarjes në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

#### III. TË NDRYSHME

Kryetarja pyet të pranishmit nëse kanë ndonjë temë tjetër për të diskutuar.

Duke qenë se të pranishmit nuk kanë tema të tjera për të diskutuar, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë, unanimitisht:

#### VENDOS



1. Mandatimin e Administratores së Shoqërisë, Znj. Ajola Xoxa, ose një personi tjetër të autorizuar prej saj me shkrim, që të kryejë regjistrimin e këtij vendimi të Asamblesë së Përgjithshme pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, ASHK, sikurse edhe çdo institucioni tjetër ku mund të jetë e nevojshme; gjithashtu edhe kryerjen

3

e të gjitha veprimeve të nevojshme apo të dobishme me qëllim zbatimin e të gjitha vendimeve të marra në këtë mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.

Duke qenë se nuk ka çështje të tjera për të diskutuar dhe duke qenë se askush tjetër nuk e kërkoi fjalën, Kryetarja e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 12:30.

Znj. Valbona Xoxa

  
  
Kryetare e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë

Znj. Xhoi Skënderasi



Sekretar i Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë

Znj. Greta Domi

Përfaqësuese ligjore në votim për aksionarin Znj. Ajola Xoxa

